

**UDHËZIM**  
**Nr.3, datë 26.6.1990**

**PËR ZBATIMIN E DEKRETIT “PËR SHPRONËSIMET DHE MARRJEN NËRDORIM TË PËRKOHSHËM TË PASURISË”**

Në zbatim të dekretit nr.4494, datë 31.3.1969 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë“, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Shpronësimi i pasurisë së paluajtshme, pronë e personave të veçantë, kooperativave bujqësore dhe organizatave shoqërore, bëhet vetëm kur është nevoja konkrete për ngritjen e objekteve ekonomike e socialkulturore, për zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve e të qendrave të tjera të banuara, për ndërtimin e objekteve që kanë të bëjnë me rritjen e aftësisë mbrojtëse të vendit, si dhe për plotësimin e nevojave të tjera shtetërore e shoqërore.

2. Shpronësimi i pasurisë bëhet me vendim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ose të rajoneve për Tiranën.

3. Pasuria që shpronësohet, në çdo rast vlerësohet duke plotësuar këto dokumente: a) preventivin e ndërtesës sipas çmimeve të manualeve të Ekonomisë Komunale, që janë në fuqi në kohën e shpronësimit, të shoqëruar me projektin ose me skica dhe përshkrimin e llojit të elementeve kryesore të ndërtesës; b) vërtetimin me të dhënat për përcaktimin e moshës së ndërtesës lëshuar, sipas rastit, nga organet e caktuara me dispozita të veçanta a nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit ose këshilli popullor i qytetit, atje ku nuk ka komitet ekzekutiv, nga këshilli popullor i lagjes së qytetit ose i fshatit. c) aktin teknik për përcaktimin e shkallës së amortizimit të ndërtesës që shpronësohet; ç) aktin përkatës për sasinë dhe vlefë të pemëve e të prodhimeve të tye dhe të kulturave bujqësore, që pësojnë dëme për shkak të shpronësimit.

Vlerësimi i pasurisë që shpronësohet, bëhet nga një komision i posaçëm, i cili caktohet nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ose i rajoneve për Tiranën dhe drejtohet nga seksioni i ekonomisë komunale.

4. Për shpronësimet në qytet, komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të qytetit ose i rajoneve për Tiranën cakton masën e shpërblimit të pasurisë së barabartë me vlefë të rera të saj në kohën e shpronësimit. Ky shpërblim japet në të holla ose në një pasuri tjetër.

Kur ndërtesa që shpronësohet është ndërtuar a meremetuar me kredi bankare ose fonde buxhetore, shpërblimi caktohet duke zbritur nga vlera e ndërtesës në kohën e shpronësimit vlerën e kredisë së paguar ose fondet buxhetore dhe shtetasi shkarkohet nga detyrimi. Ndërmarrja, institucioni ose organizata, për nevojat e të cilëve bëhet shpronësimi, i kalojnë bankës së shtetit përkatësisht vlerën e kredisë së paguar ose fondet buxhetore, që zbriten nga vlera e ndërtesës në kohën e shpronësimit.

5. Shtetasi që i shpronësohet banesa, me pëlqimin e tij mund t’i japë banesë në pronësi kundrejt pagesës, ose leje ndërtimi, për të bërë shtëpi të re, duke e ndihmuar, në rast nevojë, edhe me kredi bankare ose mund t’i jepet banesë shtetërore me qira. Kur shtetasit i jepet banesë shtetërore me qira, i sigurohet një sipërfaqe banimi aq sa ka pasuri, por jo më tepër sesa norma që i takon.

6. Për shpronësimet në fshat, kur fshatarëve që u shpronësohet banesa nuk ka mundësi t’u jepet banesë tjetër, të shpërblehen në masën e vlefës së plotë të pasurisë së shpronësuar. Në këtë rast komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ose i rajonit për Tiranën t’u sigurojë pronarëve, kundrejt pagesës, amterialet që mund t’u nevojiten për ndërtimin e shtëpisë së re dhe, në rast nevojë, të ndihmohen edhe me kredi bankare.

7. Për shpronësimet masive përndërtimin e veprave të mëdha, ministritë ose institucionet e tjera qendrore, në interes të të cilave bëhet shpronësimi, i paraqiten Kryesisë së Këshillit të Ministrave propozimin përkatës për sistemimin e banrëve. Në këto raste shpërblimi i shpronësimit përdoret për ndërtimin e banesave të reja nga shteti dhe shtetasve që shpronësohen, u jepet banesë në pronësi me sipërfaqe banimi aq sa kanë pasur por jo më tepër sesa norma që u takon.

8. Likuidimi i shpërblimit të pasurisë së shpronësuar, kur shtetasit i jepet banesë shtetërore me qira, bëhet pasi të jetë mbushur ose të jetë marrë në dorëzim ndërtesa nga ndërmarrja, kooperativa bujqësore ose organizata, në dobi të të cilave është bërë shpronësimi. Nga marrja e vendimit deri në

këtë kohë shtetasi e mban banesën në përdorim pa qira. Kur shtetasit i jepet banesë në pronësi kundrejt pagesës, ose leje ndërtimi për të bërë shtëpi të re, shpërblimi i jepet me marrjen e vendimit të shpronësimit.

9. Objektet që shpronësohen, të prishen nga ndërmarrja që do të caktojë komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ose i rajoneve për Tiranën. Ndërmarrja duhet të rikuperojë me inventar të rregullt materialin e ndërtimit që rezulton nga prishja, për të përdorur vetë ose t'ua shesë ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore a shtetasve. Vlera e materialeve që rikuperohen, përcaktohet me akt të veçantë nga komisioni i posaçëm i shpronësimit dhe përdoret për të përballuar një pjesë të shpërblimit.

10. Rregullat e caktuara në këtë udhëzëm të zbatohen për të gjitha shpronësimet që do të bëhen pas daljes së tij.

Për pasuritë e shpronësuara, të cilat nuk janë shembur ose nuk janë vënë në përdorim të shtetit, të kooperativave bujqësore a të organizatave shoqërore deri ditën e hyrjes në fuqi të dekretit nr.7384, datë 12.6.1990, shpërblimi i shpronësimit të jepet në masën e vlefës reale të tyre, duke i rivlerësuar këto pasuri sipas kriterëve të këtij udhëzimi.

11. Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.4, datë 3.4.1975 “Për zbatimin e dekretit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë”, dhe udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 21.4.1980 “Për disa probleme në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 3.4.1975”, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**ADIL ÇARÇANI**